

NewsLetter



Years

THE OFFICIAL NEWSLETTER OF THE AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE IN ALBANIA

OPINION EKONOMIK

Mega kriza në Turizmin Shqiptar si pasojë e COVID-19



ENI XHEKO

Hotel Xheko Imperial

» Në faqen 4

COVID 19- ECONOMIC NEWS BESIMI NË EKONOMI

nga bizneset dhe konsumatorët bie në nivele minimale historike nga Covid-19

REVISTA MONITOR


» Në faqen 5

LAJME AMCHAM

AmCham organizon trajnimin mbi të ardhmen e biznesit në post Covid 19

VAZHDIMI I BIZNESIT NË EPOKËN E RE DIGJITALE

Në faqen **2**



TRAJNIMI

Përzgjedhja e talenteve në Normalitetin e Ri - Një perspektivë Digjitale

Normaliteti ri digjital në të cilin po punojnë bizneset për t'ju përshtatur epokës së re post Covid-19, ka shndërruar shumë nga proceset e punës mes të cilave edhe rekrutimin.


Për të sjellë një perspektiv të qartë të mënyrës se si mund të kryhet një rekrutim nëpërmjet teknologjisë dixhitale, Dhoma Amerikane në bashkëpunim me AIMS International ka organizuar trajnimin ...

Në faqen **3**



AmCham organizon trajnimin mbi te ardhmen e biznesit në post Covid 19

VAZHDIMI I BIZNESIT NË EPOKËN E RE DIGJITALE



Në një botë të goditur nga pandemia ku shëndeti dhe ekonomia u futën në një krizë të paprecedentë, të sigurosh vazhdimësinë nuk është e lehtë. Dhoma Amerikane i ka ofruar anëtarëve të saj trajnimin me temën “Vazhdimësia e biznesit, Përshatja në një botë të re”- nën drejtimin e Znj. Agar Perez Valer – Drejtore e e Biznesit, tek Vodafone Albania.

Trajnimi është një përpjekje e anëtarëve të Komitetit të Biznesit Digjital për të orientuar anëtarët e Dhomës por dhe komunitetin e biznesit drejt një epoke të re digjitale që do ti ndihmojë kompanitë të mbiqojnë në realitetin e ri post Covid 19. Pikërisht për këtë ka folur dhe znj. Agar Perez Valer gjatë trajnimit që ka prekur në detaje impaktin që pati Covid 19 mbi biznesin, si do të përshatën me mentalitetin e ri, sig-

uria në punë me protokollet e reja në distancë dhe tendencat e forta për digjitalizim dhe automatizim të proceseve të punës.

Shoku shëndetësor dhe ekonomik u pasqyruan gjerësisht në statistikat e të gjitha vëndeve që u përshinë në këtë krizë globale. Ndërsa shqetësimi i parë dhe madhor ishte shëndeti njerëzor, ekonomia filloi të shfaqte hemorragjinë e vet dhe lëshoi sinjalin SOS. Në tre fazat që u përjetuan goditja dhe impakti i Covid 19 duket se faza e tretë është ajo në të cilën po hyjmë dhe ka të bëjë me ndryshimin radikal të të punarit dhe riformatim të tregjeve mbi një koncept të ri të zhvillimit të biznesit.

Për tu adoptuar në këtë “new era” znj. Agar Perez Valeri ka sugjeruar anëtarët e AmCham të fillojnë të përkufizojnë ndryshe vëndin e punës.

“Modeli i biznesit do të bëhet më dixhital dhe i automatizuar në të gjithë segmentet dhe industritë”

- ka shpjeguar **Znj. Agar Perez Valer** duke u përqëndruar në të gjitha hapat që duhet të kalojnë bizneset sot nga reformimi i zinxhirit të furnizimit deri në ndryshimet radikale që do të pësojnë politikat qeveritare, shoqëria dhe sjellja e konsumatorëve.

Një testim i sjelljes së biznesit deri më sot ka treguar se shumë biznese kanë filluar të mendojnë për sigurinë në punë përvece punën nga distanca. Po ashtu kanë ndryshuar qëndrim edhe konsumatorët, dy të tretat e të cilëve mendojnë se duhet të kenë një planifikim të kujdesshëm financiar dhe raportojnë se koronavirusi ka ndikuar në të ardhurat e tyre familjare. Vetë drejtuesit


e kompanive kanë filluar të shkruajnë ndjeshëm shpenzimet e tyre duke u përgatitur për një situatë edhe më të vështirë financiare. Por dicka jo vetëm nuk e kanë reduktuar por kanë filluar të investojnë fuqishëm. Shpenzojnë në cloud, robotikë dhe analitikë të përparuar

Sipas të dhënave 24% e drejtuesve të financave parashikojnë më shumë shpenzime për automatizimin e procesit robotik, 20% parashikojnë më shumë shpenzime për teknologjitë ERP me bazë cloud, dhe 19% parashikojnë më shumë shpenzime për analiza të përparuara.

Por çfarë duhet të bëjmë për t'u adoptuar në “new era”? Të minimizosh rrisqet dhe të rrisësh oportunitetet, do të jetë moto e planit strategjik të çdo biznesi. Eshhtë koha që të gjithë të kthehen në digjital, dhe puna për të konvertuar të gjitha segmentet e biznesit në digjital, duhet të fillojë me urgjencë.

Në listën e detyrave të saj për biznesin, znj. Agar Perez Valer vendosi edhe ndryshimin rrënjësor të mënyrës se si punohet, komunikohet dhe angazhohen me klientët. Sot lidhja B2B dhe B2C duhet të jetë më e fortë se kurrë dhe digjitalizimi është mënyra se si bizneset mund tja dalin.

AMCHAM ALBANIA DHE AIMS INTERNATIONAL ORGANIZOJNË TRAJNIMIN:



Normaliteti ri digjital në të cilin po punojnë bizneset për t'ju përshtatur epokës së re post Covid-19, ka shndërruar shumë nga proceset e punës mes të cilave edhe rekrutimin.

Për të sjellë një perspektiv të qartë të mënyrës se si mund të kryhet një rekrutim nëpërmjet teknologjisë dixhitale, Dhoma Amerikane në bashkëpunim me AIMS International ka organizuar trajnimin “Përzgjedhja e talentëve në Normalitetin e Ri - Një perspektivë Digjitale” mëpërmjet referimit të Endri Ndoni, Konsulent i HR, AIMS International Albania. Si konstatohen dhe rekrutohen talentet në normalitetin e ri, ciklet që ndjek një rekrutim on line dhe këshillat dhe praktikrat më të mira në rekrutimin e tyre, janë shpjeguar në trajnimin e organizuar, i cili është ndjekur me mjaft interes nga anëtarët.

Ndërsa ekonomia globale ka kaluar nëpërmjet fazave të ndryshme të zhvillimit ekonomik dhe teknologjik, nga kriza globale financiare dhe recesioni i 2008 tek platforma 5G, transformimet digjitale dhe planet e zhvillimit në 2019, vjen 2020-ta kur pandemia ndryshon gjithçka. Vazhdimi është i mundur vetëm nëpërmjet teknologjive digjitale, dhe kjo është ajo çfarë po bëjnë dhe drejtuesit e HR për kompanitë e tyre.

Gjatë takimit, z. Ndoni i ka shpjeguar anëtarëve, se hapi i parë është vlerësimi dhe menaxhimi i krizës për të vazhduar më pas me zhvendosjen virtuale dhe mundësitë për kontakte dhe bashkëpunim social. Në këto kushte do të kryhen intervistat on line që për ekspertët e HR janë një mundësi mjaft e mirë për kompaninë. “Një proces i rekrutimit nëpërmjet teknologjisë dixhitale mund ti kursejë biznesit qindra orë dhe t’ju ndihmojë të bëni oferta më të shpejta për talentin më të mirë” ka shpjeguar Endri Ndoni

PËRZGJEDHJA E TALENTEVE NË NORMALITETIN E RI - NJË PERSPEKTIVË DIGJITALE



për anëtarët e Dhomës Amerikane.

Teknika të intervistimit dhe këshilla se si duhet ta zhvillojnë atë, për të konceptuar qartë talentin nëpërmjet një interviste on-line, ka përbërë një pjesë të rëndësishme të

trajnimin. Z. Ndoni ka shpjeguar se kjo vjen si rrjedhojë e përshtypjes që krijon eksperti i HR që zhvillon intervistën por dhe mbështetur në mënyrën e komunikimit, prezantimin dhe dialogun që zhvillon me kandidatin.



Eni Xheko

Hotel Xheko Imperial

Mega kriza në Turizmin Shqiptar si pasojë e COVID-19

C OVID-19 ka prekur çdo sektor në të gjithë globin por industria e hotelerisë është ndër më të goditurat. Turizmi në Shqipëri pësoi një Mega krizë në tre muorin e dytë të 2020 menjëherë pasi filloi rikuperimin nga Termeti i 2019.


Sipas ekspertëve industria e hotelerisë mund të shohë një cikël të zgjatur të rikuperimit prej 12-18 muajsh, ku të ardhurat mund të arrijnë në 30-50% të niveleve të vitit 2019. Ndërsa rikuperimi në nivelet para-COVID-19 mund të zgjasë deri në 2023 ose më vonë.

Në mbarë botën, hotelet janë duke ndjekur politika agresive të cilat po mbështeten edhe nga programet shtetërore.

RIMËKËMBJA E INDUSTRIË SË HOTELERISË

Hoteleria në Shqipëri është në një krizë të thellë dhe ka nevojë për ndërhyrjen e menjëhershme të Qeverisë. Pagesa e punonjësve me 40,000 Lek nuk adresoi problematikën reale të bizneseve ndërkohë që edhe paketa e propozuar për kredinë sovranë nuk është aspak e përshtatshme për hotelet me kushtet që ajo ofron. Qeveria duhet të ndërhyjë me një plan strategjik konkret nëpërmjet një paketë të tretë e cila do nxirrte këtë industri nga kjo krizë ekzistenciale.

Disa nga rekomandimet afatshkurtra dhe afatmesme që i janë propozuar qeverisë nga Shoqata e Turizmit Shqiptar janë:



Kredia Sovrane me interes zero, subvencion për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve, të hiqet taksa e pronës për vitin 2020, hartimi

i programeve të mbështetjes me grante ndërkombëtare, marketing dhe promovim të Shqipërisë në tregjet prioritare dhe potenciale me një strategji për marketingun digjital, programe incetivash për stimulimin e udhëtimit etj.

MASAT QË DUHEN MARRË NGA HOTELIERËT

Drejtimesit e hoteleve do luajnë një rol të rëndësishëm për ta shtyrë këtë industri përpara duke ndryshuar mënyrën e operimit të hoteleve. Nuk mund të kemi një plan global pasi çdo rajon ka nuancat dhe veçoritë e tij por mund të shndërrohen në Avatar më të mprehtë. Strategjia e mbijetesës gjatë kësaj krize mund të shndërrohet në një formulë suksesi edhe pas COVID-19.

Disa nga strategjitë që mund të ndjekin hotelierët janë:

- » Përdorimi i kapitalit njerëzor në mënyrë më produktive nëpërmjet: reduktimit të shkallëve të hierarkisë manaxheriale, eliminimit të dublikimit të përgjegjësive, mekanizma të ndryshme për kompensimin e pagave.
- » Të zëvendësojnë disa shërbime të brendshme me burime të jashtme (*outsourcing*)
- » Sigurimi i klientëve nëpërmjet përgatitjes së një plani parandalimi të përhapjes së virusit në ambientet e hotelit duke e publikuar atë në të gjithë kanalet kryesore siç janë faqja e internetit, mediat sociale dhe e-mailit.
- » Të synojnë të tërheqin klientë vendas krahas klientëve ndërkombëtar nëpërmjet promovimit të paketave të ndryshme
- » Të jenë kreativ!

“Në kohë krize, është e mrekullueshme se çfarë do të bëjë imagjinata.” - Ruskin Bond



REVISTA MONITOR

Goditja që i ka dhënë ekonomisë Covid-19 ka bërë që treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) gjatë tremujorit të dytë të shënojë nivelin më të ulët historik që prej fillimit të matjes së tij në vitin 2002, raporto i Banka e Shqipërisë. Tkurrja e treguesit me 50.2 pikë e zhvendosi atë pranë vlerës 52.6 dhe ndjeshëm nën mesataren e tij afatgjatë (Grafik 1). Kontraktimi i TNE-së pasqyroj si përkeqësimin e besimit të bizneseve, më në veçanti në sektorin e shërbimeve, ashtu edhe besimin e konsumatorëve. Besimi i bizneseve dhe i konsumatorëve shënoi nivelet më të ulëta në kohë.

Treguesi i besimit në sektorin e industrisë (TBI) thelloi rënie gjatë tremujorit të dytë, duke rezultuar 24.0 pikë përqindje më poshtë nivelit të një tremujori më parë. TBI-ja ra nën mesataren afatgjatë të saj për të parën herë pas 6 vitesh dhe shënoi nivelin më të ulët historik (Grafik 2). Kontraktimi i fortë i treguesit i atribuohet kryesisht rënies së balancës së prodhimit, me 50.7 pikë përqindje, dhe në një masë më të vogël, rënies së balancës së kontratave porositëse, me 28.9 pikë përqindje. Komponenti tjetër përbërës i TBI-së, balanca e gjendjes së inventarëve, kontribuoi në kahun rritës për dinamiken e treguesit. Rënie të ndjeshme shënuan edhe balanca të tjera të vrojtimit të industrisë, si gjendja financiare, kontratat porositëse nga eksportet, pritjet për ecurinë e punësimit në tremujorin e ardhshëm, ashtu edhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve. Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve rezultoi rreth 64.0%, niveli më i ulët historik. Ndërkohë, balanca e pritjeve për ecurinë e prodhimit në tremujorin e ardhshëm u përmirësua lehtësisht.

Treguesi i besimit në sektorin e ndërtimit (TBN) ra me 29.5 pikë përqindje gjatë tremujorit të dytë, duke u zhvendosur edhe më poshtë mesatares së tij historike (Grafik 3). Tkurrja e fortë e TBN-së pasqyroj kryesisht rënien e balancës së aktivi-

titit ndërtues me 50.7 pikë përqindje. Në kahun rënës kontribuoi edhe balanca tjetër formuese e TBN-së, kontratat porositëse, ndonëse rënia e saj me 8.3 pikë përqindje gjatë tremujorit rezultoi relativisht më e zbutur. Balancat e tjera të vrojtimit për këtë sektor, si gjendja financiare, punësimi dhe pritjet për të në tremujorin e ardhshëm, si edhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve shfaqën gjithashtu dinamika rënës gjatë periudhës në analizë. Rënia tremujore e shkallës së shfrytëzimit të kapaciteteve në nivelin e 56.6%, e zhvendosi treguesin nën mesataren historike

me 7.3 pikë përqindje.

Treguesi i besimit në sektorin e shërbimeve (TBSH) shfaqti tkurrjen më të fortë midis treguesve të besimit gjatë tremujorit të dytë, me 56.6 pikë përqindje, duke shënuar edhe nivelin më të ulët historik (Grafik 4). Përkeqësimi i TBSH-së pasqyroj rënien e të dy komponentëve përbërës të tij, balancës së ecurisë së biznesit, me 58.0 pikë përqindje, dhe balancës së kërkesës, me 55.3 pikë përqindje. Rënie shënuan edhe balancat e tjera të vrojtimit në sektorin e shërbimeve, si gjendja financiare,

punësimi dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve. Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve qëndroi pranë vlerës 70.2%, rreth 6.0 pikë përqindje poshtë mesatares historike të saj. Ndërkohë, pritjet e bizneseve të shërbimeve për ecurinë e kërkesës dhe punësimit në tremujorin e ardhshëm rezultuan të përmirësuar.

Treguesi i besimit në sektorin e tregtisë (TBT) u tkurr me 19.8 pikë përqindje gjatë tremujorit të dytë, duke shënuar minimumin historik për kohën e kryerjes së vrojtimit të besimit në këtë sektor (Grafik 5). Dinamika rënës e TBT-së u përcaktua pothuajse tërësisht nga rënia e balancës së ecurisë së biznesit me 38.4 pikë përqindje, në një kohë që rënia e balancës tjetër formuese, pritjet për ecurinë e punësimit në tremujorin e ardhshëm, rezultoi relativisht më e lehtë. Edhe balancat e tjera të vrojtimit në tregti, si gjendja financiare, punësimi dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve shënuan rënie. Bizneset e përfshira në aktivitetet tregtare rezultojnë të kenë shfrytëzuar kapacitetet e tyre prodhuese me normën më të ulët të shënuar në kohë, rreth 65.0%. Ndërkohë, balanca e pritjeve për ecurinë e biznesit në tremujorin e ardhshëm shfaqti përmirësim.

Treguesi i besimit konsumator (TBK) thelloi tendencën rënës gjatë tremujorit të dytë, duke shënuar gjithashtu nivelin më të ulët historik në kohë (Grafik 6). Rënia e TBK-së me 6.3 pikë përqindje pasqyroj përkeqësimin e të katër komponentëve përbërës të treguesit, përkatësisht balancës së situatës së përgjithshme ekonomike të pritur në vend, me 10.0 pikë përqindje, balancës së situatës financiare të pritur të familjes, me 7.9 pikë përqindje, balancës së blerjeve të mëdha, me 6.8 pikë përqindje dhe balancës së të ardhurave dhe shpenzimeve, me 0.8 pikë përqindje.

BESIMI NË EKONOMI

nga bizneset dhe konsumatorët bie në nivele minimale historike nga Covid-19

